DITA BOTËRORE E AIDS-it

Me **1 Dhjetor** shënohet Dita Botërore e AIDS-it, ditë e cila në shumë
pjesë të botës kalon duke mësuar dhe informuar popullatën lidhur me këtë
sëmundje dhe njëkohësisht vazhdon të jet një çështje me rëndësi globale e
shëndetit publik.

Arsyeja e shënimit të kësaj dite në tërë Botën si dhe në Kosovë është:

**Thirrje për AKSION për të gjithë personelin dhe vendimmarrësit shëndetësor, liderët në komunitet, menaxherët e programeve të HIV-it dhe
partnerët tjerë që me kontributin e tyre të përkrahin masat e parandalimit dhe
kontrollit të HIV/AIDS-it**

Në
mbarë botën:

- Në fund të vitit 2019 rreth 38 milion njerëz ishin me HIV.
- Llogaritet se 1 në 5 njerëz që jetojnë me HIV nuk e dijnë se janë të infektuar.
- Deri tani nga HIV-i kanë ndërruar jetë 33 milion njerëz.
- Gjatë vitit 2019 kanë vdekur 690.000 njerëz me HIV për shkak të mungesës së shërbimeve për

HIV, ndërsa 1.7 milion
tjerë janë infektuar.

- Llogaritet se rreth 62% të infeksioneve
të reja në mbarë botën i takojnë grup moshave 15-49 vjeç dhe grupacioneve të
veçanta (narkomanët, punëtorët
e seksit, transgjinorët, të burgosurit, meshkujt që kanë seks me meshkuj).
- Infeksioni me HIV është i pashërueshëm.
Megjithatë, terapia efikase antiretrovirale mund ta kontrollojë virusin dhe të
ndihmojë parandalimin e bartjes së infeksionit tek njerëzit tjerë.

**Ndikimi i infeksionit me COVID-19 tek
personat me HIV është ende duke u hulumtuar. Personat me HIV janë të rrezikuar
nga sëmundjet serioze nëse kanë vlera të ulta të qelizave imunitare CD4 dhe
nëse nuk marrin terapi efektive antiretrovirale.**

Kosova klasifikohet si vend me shkallë të ulët të epidemisë por me potencial të rritjes, posaçërisht në mesin e popullatës MSM.

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se ne nuk kemi epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV.

Që nga viti 1986 deri me 1 dhjetor të vitit 2020, në Kosovë janë raportuar 132 raste me HIV. Deri më tani 51 kanë vdekur si pasojë e
AIDS-it. Në vitin 2020, janë raportuar 2 raste me HIV infeksion.

Qendrat për Këshillim dhe Testim Vullnetar për HIV/AIDS ekzistojnë që nga viti 2003 në Kosovë dhe veprojnë në kuadër të Klinikës Infektive
në QKUK, në IKSHPK gjithashtu edhe në në Ferizaj, Prizren dhe Pejë.

Kampanja për vitin 2020 është me moton:

"Ta përfundojmë epideminë e HIV/AIDS-it: Qëndrueshmëri dhe Ndikim"

Mesazhet kryesore dhe thirrja për veprim:

- Përtëritja e luftës për t'i dhënë fund AIDS-it; është koha për të investuar, përtërirë dhe integruar shërbimet e HIV me kujdesin e gjerë shëndetësor.
- Përdorimi i shërbimeve inovative të HIV-it, për të siguruar kujdes të vazhdueshëm për personat me HIV gjatë pandemisë, p.sh. përshkrimi i terapisë për disa muaj.
- Angazhimi, përkrahja dhe mbrojtja e punëtorëve shëndetësor dhe atyre në komunitet gjatë ofrimit të shërbimeve për HIV dhe COVID-19.
- Dhënia e përparësisë grupeve vulnerabile. Ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve të HIV-it gjatë COVID-19 për fëmijët, adoleshentët dhe grupacionet e veçanta.

COVID-19 dhe HIV

Personat me HIV
duhet të jenë shumë të kujdesshëm në respektimin e masave të përgjithshme për
të shmangur infeksionin me COVID-19:

- Bartja e maskës,
- Mbajtja e distancës fizike,
- Mbajtja e higjienës personale dhe ambientit,
- Evitimi i udhëtimeve dhe tubimeve të panevojshme.

Në veçanti,
duhet parapregaditur për infeksion të mundshëm, duke:

- Siguruar furnizim të mjaftueshëm (30-90 ditë) me barna për HIV.
- Vazhduar të merrni barnat për HIV, me që ato ndihmojnë që ta ruani sistemin imunitar.
- Mirëmbajtur stilin e shëndoshë të jetës (të ushqyerit e shëndetshëm, gjumë të mjaftueshëm së paku 8 orë në ditë dhe largimi nga
  stresi).

Solidariteti dhe ndarja e përgjegjësisë ndihmojnë ta luftojmë coronavirusin,
përfundojmë epideminë e AIDS-it dhe garantojmë të drejtën për shëndet për të
gjithë.

Fillon shpërndarja e vaksinave të gripit sezonal nëpër komunat e Kosovës

Prishtinë, 30 Nëntor
2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti
Kombëtar i Shëndetësisë Publike i informojnë qytetarët e Republikës së Kosovës
se 165.000 vaksinat e para të gripit sezonal, të siguruara nga MSh në funksion
të parandalimit të gripit sezonal kanë arritur në Kosovë dhe do të imunizohen
grupet më të rrezikuara të popullatës në shtetin tonë.

Ministri i
Shëndetësisë z. Armend Zemaj dhe shefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, z. Murat
Sahin, të shoqëruar nga drejtori ekzekutiv i IKSHPK-së, z. Naser
Ramadani, morën pjesë sot në fillimin e shpërndarjes së vaksinave kundër gripit
sezonal për këtë vit në Kosovë.

Që nga mëngjesi i sotëm, ekipet e Qendrave
Kryesore të Mjekësisë Familjare të komunave të Kosovës, sipas ftesës që u është
bërë një ditë më parë nga MSh dhe IKSHKP, kanë filluar

furnizimin me vaksina,
me të cilat Njësitë e tyre të vaksinimit do t’i vaksinojnë qytetarët në ditët
në vijim.

Vaksinat kundër gripit sezonal, të cilat do të
përdoren sivjet, sipas rekomandimeve të bëra nga OBSh, do të jenë katër
shtamëshe dhe si të tilla e rrisin fuqinë mbrojtëse ndaj virusëve më agresivë
në qarkullim të gripit sezonal.

Ministri Zemaj tha se me 165.000
vaksinat e para, të siguruara, do të imunizohen grupet më të rrezikuara të
popullatës në shtetin tonë.

“Ministria është në proces të
sigurimit edhe të 50.000 vaksinave të tjera me çka arrijmë të shtojmë për 100
për qind numrin e vaksinave krahasuar me vitin paraprak. Vaksinat e blera nga
Ministria e Shëndetësisë përmes UNICEF-it do të shpërndahen dhe jepen falas për
qytetarët e vendit tonë. Do të ketë vaksina të mjaftueshme, sipas planit të
vaksinimit dhe, sipas nevojës, do të mund të sigurojmë edhe të tjera”, tha
Ministri Zemaj.

Ai theksoi se, me qëllim të
parandalimit të virusëve sezonal agresiv në qarkullim, MSh ka siguruar vaksina
katër – valente, që kanë fuqi më të madhe

vepruese/parandaluese ndaj
këtyre virusëve.

Shefi i Zyrës së UNICEF-it, z. Murat
Sahin, tha se UNICEF-i i ka punuar ngushtë me MSh-në në sigurimin e vaksinës
kundër gripit sezonal dhe se kjo organizatë do të punojë me MSh-në edhe në
përpjekjet për të prokuruar dhe furnizuar me vaksina kundër COVID-19.

Drejtori i IKSHPK-së, z. Naser Ramadani, tha se
vaksinat do të fillojnë të shpërndahen nëpër njësitë e vaksinimit të Kujdesit
Parësor në Komuna (QKMF) ku edhe do të bëhet vaksinimi i grupeve prioritare
sipas planit të bërë më herët

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i
siguron qytetarët se po e monitoron me kujdes situatën epidemiologjike në vend
dhe ka rritur vigjilencën për t’u përballur me raste të Gripit sezonal.